



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2327, datë 28.06.2013

Për

“Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 28.06.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012, datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”), ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimi i procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Enet sh.p.k. - Albtelecom sh.a.

BAZA LIGJORE:

1. Neni 120 e vijues, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (**Ligji nr. 9918**);

2. Neni 46 e vijues të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore nr. 18 “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP” (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 i ndryshuar,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Shkresa e sipërmarrësit Enet sh.p.k. me nr. 2013/36Prot, datë 12.4.2013 (nr. 725Prot., i AKEP, datë 15.4.2013) “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Albtelecom sh.a. dhe detyrimin e tij për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit me Enet sh.p.k.”;
- Shkresa e Enet sh.p.k. me nr. 56/1Prot. datë 30.5.2013, (nr. 976Prot. i AKEP, datë 30.5.2013) “Mbi takimin mes Enet sh.p.k. dhe kërkesë për ndërhyrjen e AKEP dhe detyrimin e Albtelecom sh.a. për lidhjen e MF”;
- Shkresa e Enet sh.p.k. me nr. 48/1, datë 25.4.2013 (nr. 748/1Prot i AKEP, datë 29.4.2013) “Mbi tuajën datë 12.4.2013 në lidhje me kërkesën në AKEP për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni me Albtelecom dhe detyrimin e tij për lidhje të MI me Enet sh.p.k.”;
- Shkresa nr. 179/1Prot, datë 22.4.2013 (725/2Prot. i AKEP, datë 23.4.2013) e Autoritetit të Konkurrencës “Në lidhje me ankesën e shoqërisë Enet sh.p.k.”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 1191/1Prot, datë 12.4.2013 (nr. 748Prot. i AKEP, datë 16.4.2013) “Përgjigje tuajës “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Albtelecom sh.a. për moslidhje marrëveshje”;
- Shkresa e Enet sh.p.k. me nr. 2013/14Prot. datë 20.3.2013 (nr. 542Prot. i AKEP, datë 21.3.2013), “Kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje me Albtelecom për moslidhje interkoneksioni”;
- Shkresa e Albtelecom sh.a. me nr. 6168/1Prot. datë 23.1.2013 (nr. 143/1Prot. i AKEP, datë 24.1.2013) “Mbi plotësimin e kërkeses për lidhje marrëveshje interkoneksionit”;
- Shkresa e Enet sh.p.k. me nr. 2013/1Prot. datë 17.1.2013 “Kërkesë për lidhje marrëveshje interkoneksioni”;
- Shkresa e Enet sh.p.k. me nr. 2013/2Prot, datë 6.2.2013, “Kërkesë për lidhje marrëveshje interkoneksioni”;
- Shkresa e Enet sh.p.k. me datë 11.12.2012, “Kërkesë për lidhje marrëveshje interkoneksioni”;

- Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*),

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

Enet sh.p.k. me anë të shkresës nr. 2013Prot. datë 12.4.2013, ka depozituar në AKEP kërkesë për zgjidhje mosmarrëveshje interkoneksioni me Albtelcom. Enet shpjegon se për t'u mundësuar pajtimtarëve të tij shërbimin telefonik fiks në bashkinë Elbasan, me datë 28.1.2013 i ka paraqitur Albtelcom kërkesë për lidhje e marrëveshjes së interkoneksionit në përputhje me RIO-n e Albtelcom të ndryshuar me VKD nr. 1884, datë 19.4.2013.

Enet sqaron se, më datë 6.2.2013, Albtelcom-it i është dërguar dokumentacioni shtesë me të gjitha dokumentet e kërkuara nga RIO. Janë dhënë shpjegimet teknike, duke i bërë të qartë që fibra e Enet është instaluar pranë zyrave të Albtelcom në Elbasan. Enet ka blerë, furnizuar dhe instaluar të gjitha pajisjet e telefonisë përfshirë pajisjet e interkoneksionit me Albtelcom me sinjalizim CC7, sipas RIO se Albtelcom. Nga Albtelcom nuk pati asnjë përgjigje, duke vonuar pa arsye ligjore lidhjen e MI.

Më datë 20.3.2013, i është dërguar shkresë Albtelcom duke i kërkuar arsyet e vonës dhe nëse duhen plotësime nga Enet. Në këtë shkresë Enet i ka kujtuar Albtelcom se është në shkelje të afateve ligjore të RIO dhe se në rast të moslidhjes së MI do t'i kërkojë AKEP të detyrojë Albtelcom të lidhë MI me Enet në përputhje me kërkesat e Rregullores për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Albtelcom nuk është përgjigjur.

Enet, sqaron se Albtelcom me këtë veprim të qëllimshëm pengon konkurrencën në bashkinë Elbasan, duke ditur që Enet ka shtrirje rrjeti shumë të gjerë në këtë bashki dhe numër të konsiderueshëm pajtimtarësh internet një pjesë e mire e të cilëve do të jenë përdorues të telefonise fikse.

Enet bën me dije se moslidhja e MI me Albtelcom i ka shkaktuar dëme të konsiderueshme financiare, pasi ka blerë të gjitha pajisjet e telefonisë fikse, është krijuar një liste pritje me mbi 100 abonentë të cilët presin shërbimin e Enet, si dhe nga mungesa fitimit nga mosushtrimi i këtij aktiviteti.

Në këto kushte Enet sh.p.k. i kërkon AKEP zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe detyrimin e Albtelcom për lidhjen e MI në përputhje me kërkesat e rregullores së AKEP nr. 18, datë 11.6.2013.

Albtelcom me shkresën nr. 1191/1Prot, datë 12.4.2013, i përgjigjet Enet sh.p.k., duke e vënë në dijeni për ndryshimet e ndodhura në rrjetin e vet në kuadër të investimeve të mëdha dhe kalimin në teknologjinë IP. Albtelcom i ka ofruar Enet sh.p.k. shërbimin e interkoneksionit në 2 pika interkoneksioni kombëtare dhe 2 pika interkoneksioni rajonale (*përfshirë edhe 2 pika interkoneksioni lokale*).

AKEP, në përgjigje të shkresës së Enet sh.p.k. dhe pas marrjes dijeni të shkresës së Albtelcom sh.a. nr. 1191/1Prot, datë 12.

Enet sh.p.k. në përgjigje të shkresës së më sipërme, shprehet se Albtelecom është në shkelje të cdo afati ligjor dhe afateve të RIO-s për lidhjen e MI. Enet sqaron se janë kryer investimet dhe janë furnizuar pajisjet në përputhje me kërkesat e RIO-s së Albtelecom. Enet shprehet i gatshëm për lidhje me E1 në Elbasan dhe për sa kohë pikat e tjera nuk janë miratur nga AKEP. Albtelecom duhet të realizojë interkoneksion në Elbasan me Enet dhe më pas të veprojë si me të gjithë operatorët alternativë. Gjithashtu, Enet shprehet edhe për paqartësi teknike në përgjigjen e kthyer nga Albtelecom, duke i kërkuar takim dypalësh me specialistë të fushës teknike.

Takimi u zhvillua më datë 15.5.2013, ku Enet shprehu rezervat për tejkalimin e afateve ligjore të lidhjes së MI. Nga Albtelecom u shpjegua se nuk donin të interkonektoheshin në Elbasan si me të gjithë operatorët e tjerë alternativë por ofruan një zgjidhje tjetër: interkoneksion në Tiranë ose Durrës dhe bashkëvendosje në Elbasan, ku Enet ka aktualisht vendndodhjen.

Në përfundim, nga Enet u kërkua lidhja e interkoneksionit në përputhje me RIO-n aktuale në fuqi të Albtelecom dhe ligjin nr. 9918 të ndryshuar. Për sa kohë kjo RIO nuk ka ndryshuar, Albtelecom duhet të lidhë interkoneksion me Enet aty ku është caktuar numeracioni dhe kodi ISPC nga AKEP. Nëse AKEP do të miratojë ndryshime në mënyrën e interkonektimit (RIO) Enet do të veprojë si të gjithë operatorët e tjerë.

Pas këtij takimi nuk ka përgjigje, reagim apo propozim nga Albtelecom.

Enet shpjegon se, ka investuar bazuar në ligjin nr. 9918 të ndryshuar dhe RIO-n e Albtelecom në fuqi dhe është duke u dëmtuar shumë monetarisht dhe moralisht nga vonesa e pajustifikuar ligjorisht dhe nga moslidhja e interkoneksionit.

Sa më sipër, Enet sh.p.k. në kushtet e heshtjes së Albtelecom sh.a. dhe moszbatimit të RIO-s në fuqi rikërkon ndërhyrjen e AKEP për detyrimin e Albtelecom sh.a. për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit duke vendosur afat të qartë për Albtelecom sh.a.

Duke qenë se sipërmarrësit Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. megjithë përpjekjet e bëra nuk kanë arritur të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis tyre, për sa i takon lidhjes së marrëveshjes së interkoneksionit, AKEP, në zbatim të nenit 120 të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, zgjidh mosmarrëveshjet ndërmjet sipërmarrësve të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, në rastet kur ato lidhen me zbatimin e këtij ligji dhe të rregullave të nxjerra në zbatim të tij,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të Ligjit nr. 9918 i ndryshuar, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimin administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit.
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me përbërje si:
 - Altin Rrapaj Kryetar
 - Jonida Gjika Anëtar
 - Jetmir Braha Anëtar
 - Esmeralda Dervishi Anëtar
 - Dritan Malaj Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara Enet sh.p.k. dhe Albtelecom sh.a. për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e Vendimit;
5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E
Alketa MUKAVELATI

ANËTARË:

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkeda DOMI
4. Zamira NURÇE